



Qendrimi i Kishës Katolike ndaj Sionizmit

Description

Dr. Richard DeClue

Burimi: Richard DeClue, Disambiguating Zionism, Anti-Semitism, and Israel (March 31, 2026) (<https://www.wordonfire.org/articles/disambiguating-zionism-anti-semitism-and-israel/>)

Prej një kohe të gjatë tashmë, kanë ekzistuar konflikte të theksuara lidhur me çështje që kanë të bëjnë me shtetin-komb të Izraelit, me popullin hebre në kuptimin më të gjerë, si dhe me fenë e Judaizmit në mënyrë të veçantë. Kjo dukuri është vërejtur si në nivel global, ashtu edhe në atë kombëtar dhe brenda rretheve katolike, të cilat do të do të jenë fokusi analizës sonë. Së fundmi, këto konflikte kanë arritur një pikë kulmore.

Një faktor që kontribuon në këto polemika është vështirësia për të bërë dallimin e qartë ndërmjet këtyre tri kategorive. Megjithëse ekziston, pa dyshim, një mbivendosje ndërmjet tyre, ato nuk janë, në kuptimin e rreptë, identike. Ka praktikues të Judaizmit që nuk janë etnikisht hebrej. Ka hebrej etnikë që nuk janë fetarë. Shumica e atyre që identifikohen—qoftë në aspektin fetar apo në mënyra të tjera—si hebrej nuk banojnë në shtetin-komb të Izraelit. (Sipas një vlerësimi të vitit 2023, rreth 46 për qind e hebrejve jetonin në Izrael në atë kohë.) Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e banorëve të Izraelit nuk janë hebrej.

Për ta bërë situatën edhe më të ndërlikuar, një raport nga The Times of Israel vëren se “në mënyrë domethënëse, një pjesë e madhe e popullsisë [së Izraelit] është laike”, duke shtuar se “shumica e hebrejve izraelitë nuk janë praktikues të përpiktë të Judaizmit”. Baza e këtij raporti është si vijon: “Një sondazh i bërë nga Byroja Qendrore e Statistikave të Izraelit dhe publikuar në vitin 2021, zbuloi se ndër hebrejtë izraelitë mbi moshën 20 vjeç, rreth 45 për qind identifikoheshin si laikë ose jofetarë, ndërsa 33 për qind deklarorin se praktikonin adhurim fetar ‘tradicional’. Hebrejtë ultra-ortodoksë, të njohur në hebraisht si Haredim, përbënin 10 për qind të popullsisë.” Statusi i 12 për qindëshit të mbetur nuk specifikohet. (A shfaqen më mirë të vetëidentifikuarit si të krishterë? Nuk jam i sigurt.)

Megjithatë, shumë shpesh përdoret një gjuhë e pasaktë kur flitet për Izraelin, hebrejtë dhe Judaizmin. Dallimi ndërmjet këtyre kategorive shpesh humbet gjatë komenteve, veçanërisht në diskutimet që

lidhen me sionizmin ose antisemitizmin.

Në përputhje me këtë, dëshiroj të trajtoj disa çështje që lidhen me sionizmin, antisemitizmin dhe Izraelin, duke u mbështetur në mënyrë të konsiderueshme në një artikull të shkruar nga Papa Benedikti i XVI titulluar “Hiri dhe vokacioni pa keqardhje”

Sionizmi është ndoshta më i ndërlikuari ndër këta terma. Ai përdoret në një larmi mënyrash dhe mbështetet apo kundërshtohet për arsye të ndryshme dhe shpesh të papërputhshme. Për qëllimet tona, mund të nisim me lëvizjen ashtu siç u themelua nga Theodor Herzl. Përballë përndjekjeve (përfshirë pogromet) kundër hebrenjve në vende të ndryshme, sionizmi synonte “t’u siguronte një atdhe hebrenjve të zhvendosur, të varfër dhe që vuanin” (178). Dëshirat e Herzlit nuk u realizuan menjëherë. Më vonë, dy faktorë—Shoah dhe rënia e Perandorisë Osmane—u ndërthurën, duke çuar udhëheqësit botërorë në themelimin e një shteti hebre në Tokën e Shenjtë në vitin 1948.

Megjithatë, jo të gjithë të përfshirët kishin të njëjtat motive. Siç vëren Papa Benedikti i XVI, “Shumica e sionistëve ishin jobesimtarë dhe ishte në kushte laike që ata e bënë tokën një atdhe për popullin hebre. Por forcat fetare kanë qenë gjithmonë të pranishme në sionizëm” (178). Me fjalë të tjera, disa, por jo të gjithë—dhe me gjasë as shumica—e sionistëve në kohën e themelimit të shtetit modern të Izraelit ishin të motivuar nga arsye teologjike.

Sionizmi i hershëm ishte i diskutueshëm brenda Kishës Katolike. “Megjithatë, që nga fillimi,” raporton Papa Benedikti i XVI, “qëndrimi mbizotërues ishte se një përvetësim i tokës i kuptuar në mënyrë teologjike (në kuptimin e një mesianizmi të ri politik) ishte i papranueshëm. ... Në thelb qëndron bindja se një shtet i kuptuar në mënyrë rreptësisht teologjike—një shtet hebre i fesë [Glaubensstaat], i cili do ta shihte veten si përmbushjen teologjike dhe politike të premtimeve—është i paimagjinueshëm brenda historisë sipas besimit të krishterë dhe në kundërshtim me kuptimin e krishterë të premtimeve” (178).

Me fjalë të tjera, qëndrimi mbizotërues ndër teologët katolikë ka qenë se shteti modern i Izraelit, i themeluar në vitin 1948, nuk ka lidhje as me profecitë biblike dhe as me premtimet e bëra Abrahamit.

Ky qëndrim katolik bie në kundërshtim me pikëpamjet e mbrojtura nga disa sionistë të krishterë, si p.sh. Paula White-Cain, e cila që nga shkurti i vitit 2025 ka shërbyer si drejtuesja e parë e White House Faith Office. Ajo shërben gjithashtu si anëtare e Religious Liberty Commission. Sipas një artikulli në faqen e Paula White Ministries, ajo beson se premtimi i Zotit ndaj Abrahamit në Zanafillën 12:3 (“Unë do të bekoj ata që të bekojnë ty dhe do të mallkoj atë që të mallkon ty”) “lidhet jo vetëm me popullin hebre, por edhe me shtetin e Izraelit. ... Ne jemi të thirrur të QËNDROJMË me IZRAELIN! Kjo nuk ka të bëjë me politikën; kjo ka të bëjë me jetesën në harmoni me Fjalën e Zotit!”

Ky qëndrim u mbështet gjithashtu së fundmi nga senatori Ted Cruz gjatë një interviste me Tucker Carlson. Nga kjo perspektivë, këto figura mendojnë se mbështetja e shtetit modern të Izraelit dhe e veprimeve të tij politike përbën një urdhërim biblik. Pozicioni i tyre duket madje më i motivuar fetarisht sesa ai i shumicës së sionistëve hebrenj fillestarë. Sërish, ky lloj sionizmi i krishterë nuk përfaqëson qëndrimin katolik.

Por pikërisht këtu mund të lindë konfuzioni. Fakti që doktrina katolike nuk e sheh shtetin modern të Izraelit si përmbushje të profecive apo premtimeve biblike nuk do të thotë se katolikët duhet të jenë kundër shtetit të Izraelit si i tillë. Në këtë pikë, rikthehemi te artikulli i Papa Benediktit të XVI. Pasi thekson qartë se qëndrimi katolik nuk e kupton Izraelin e sotëm si një entitet teologjik, Benedikti shton:

“Në të njëjtën kohë, megjithatë, u bë e qartë se populli hebre, si çdo popull, ka një të drejtë natyrore për tokën e vet. ... Në këtë kuptim, Vatikani e ka njohur Shtetin e Izraelit si një shtet kushtetues modern dhe e sheh atë si një atdhe legjitim të popullit hebre, [edhe pse] arsyetimi për këtë nuk mund të rrjedhë drejtpërdrejt nga Shkrimi i Shenjtë” (178). Shteti modern i Izraelit nuk është ai për të cilin flet Bibla kur përmend Izraelin, por shteti i Izraelit mund të mbështetet për arsye të tjera.

Prandaj, kur flitet për “të drejtën e Izraelit për të ekzistuar”, duhet bërë një dallim i qartë ndërmjet arsyeve mbi të cilat mbështetet kjo e drejtë. Të pretendosh se shteti i Izraelit ka të drejtë të ekzistojë sepse kështu thotë Bibla është diçka krejtësisht e ndryshme nga të pohuarit se populli hebre ka të drejtë për një shtet të vetin sipas së drejtës natyrore. Fakti që termi sionizëm mund të përdoret për të përshkruar të dyja këto qëndrime vetëm sa e thëllon konfuzionin.

Prandaj, qartësia përkufizuese është thelbësore. Dyshoj se, kur dëgjojnë termin sionizëm, shumë njerëz sot e lidhin menjëherë atë me motive biblike dhe teologjike. Ndoshta, për këtë arsye, vetë termi nuk është shumë i dobishëm. Për arsye të tjera, edhe Adam Gregerman, profesor i teologjisë në St. Joseph’s University, bie dakord lidhur me kufizimet e përdorshmërisë së këtij termi. Siç e citon Gina Christian, ai shprehet: “Sionizmi është emërtimi për lëvizjen për vetëvendosjen kombëtare dhe sovranitetin hebre në tokën e Izraelit,” tha [Gregerman]. “Ai në fakt është bërë i parëndësishëm në të tashmen dhe një term kryesisht i padobishëm, pasi kjo tashmë ka përfunduar, përveç nëse dikush vë në pikëpyetje nëse arritjet e kësaj lëvizjeje janë sot të paligjshme,” gjë që, sipas tij, “është një diskutim krejt tjetër dhe nuk ka të bëjë me sionizmin, por me moralin dhe jetët e izraelitëve sot.”

A fortiori, do të ishte e gabuar të pohohej se të krishterët duhet të mbështesin çdo mjet që përdor qeveria izraelite për të arritur qëllimet e saj politike.

Nga pikëpamja praktike, katolikët janë të lirë të kenë mendime të ndryshme lidhur me çështjen prudenciale dhe politike nëse Izraeli duhej të ishte themeluar në kohën dhe në vendin ku u themelua në vitin 1948. Megjithatë, duke qenë se ai është krijuar dhe ekziston që atëherë, Vatikani e njeh atë si një shtet sovran me të drejta që i përkasin çdo shteti.

Njëkohësisht, Papae Benedikti i XVI këmbëngulte se edhe popujt e tjerë në rajon kanë të drejtë për tokën e tyre. Në lidhje me konfliktin e vazhdueshëm ndërmjet Izraelit dhe popullit palestinez, Benedikti i XVI mbështeti zgjidhjen e themelimit të dy shteteve. Në një fjalim të mbajtur në Tel Aviv në vitin 2009, ai deklaroi: “Le të njihet në mënyrë universale se Shteti i Izraelit ka të drejtë të ekzistojë dhe të gëzojë paqe dhe siguri brenda kufijve të dakorduar ndërkombëtarisht. Po ashtu, le të pranohet se populli palestinez ka të drejtë për një atdhe sovran dhe të pavarur, për të jetuar me dinjitet dhe për të udhëtuar lirshëm. Le të bëhet realitet zgjidhja me dy shtete dhe të mos mbetet një ëndërr.”

Duke pasur parasysh konfliktet e fundit ushtarake, duhet shtuar se e drejta për të ekzistuar dhe për të mbrojtur vendin nuk barazohet me një liri absolute për të përdorur çfarëdo mjeti. Madje, dikush mund të jetë sionist në kuptimin fetar pa mbështetur politikën e administratës aktuale izraelite. *A fortiori*, do të ishte e gabuar të pohohej se të krishterët duhet të mbështesin çdo mjet që përdor qeveria izraelite për qëllimet e saj politike. Parimet e teorisë së luftës së drejtë, me dy përbërësit e saj kryesorë—*jus ad bellum* (e drejta për luftë) dhe *jus in bello* (drejtësia në luftë)—zbatohen njësoj për Izraelin si për çdo shtet tjetër. Veprimet e Izraelit duhet të vlerësohen mbi këto baza.

Edhe nga një perspektivë biblike, do të ishte absurde të mbështetej apriori çdo vendim i qeverisë së Izraelit. Gjatë gjithë Dhjatës së Vjetër, profetët u dërguan pikërisht për të qortuar dhe kritikuar veprimet

e udhëheqjes së Izraelit. Nëse Izraeli biblik nuk ishte i imunizuar ndaj kritikës, si mund të mohohet mundësia e kritikimit të Izraelit apo të qeverisë së tij sot?

Shpresohet që sa u paraqit më sipër—pavarësisht kompleksitetit të saj—të jetë e mjaftueshmërisht e qartë, edhe pse, siç pranohet, nuk është shteruese. Megjithatë, një çështje tjetër kërkon trajtim: antisemitizmi. Edhe ndër disa prej atyre që këmbëngulin në dallimin ndërmjet Izraelit modern dhe Izraelit biblik, mund të vihet re, në praktikë, një barazim i këtyre të dyjave në retorikën e tyre. Së paku, disa prej tyre shfaqin një prirje për të ndërthurur kundërshtimin ndaj veprimeve të Izraelit me një gjuhë armiqësore ndaj popullit hebre në përgjithësi. Për rrjedhojë, kundërshtimi ndaj veprimeve të qeverisë izraelite—edhe nëse është legjitim—mund të degjenerojë shpejt në antisemitizëm, i cili nuk është i pranueshëm.

Siç shprehet dokumenti *Nostra Aetate*, “Kisha ... dënon urrejtjen, përndjekjet dhe shfaqjet e antisemitizmit, të drejtuara kundër hebrenjve në çdo kohë dhe nga kushdo qoftë” (4). Që të mos pretendohet se kjo është thjesht një formë irenicizmi pas Koncilit të Dytë të Vatikanit, le të përmendim disa burime më të hershme. Papa Pope Pius XI, në një fjalim të vitit 1938 drejtuar një grupi pelegrinësh belgë, deklaroi qartazi: “Antisemitizmi është i papranueshëm.”

Nëse kjo nuk konsiderohet mjaftueshëm e hershme për disa lexues, ndoshta fjalët e Papës Gregori i Madh do të jenë të mjaftueshme. Hebrenjtë në qytetin italian të Napolit kishin paraqitur ankesa për trajtim të padrejtë. Në letrën e tij drejtuar peshkopit të Napolit, Gregori iu përgjigj këtyre shqetësimeve:

“Ata që dëshirojnë sinqerisht të sjellin ata që janë jashtë fesë së krishterë në besimin e drejtë duhet të angazhohen me përkushtim në shfaqje mirësjelljeje dhe butësie, jo ashpërsie, që të mos ndodhë që armiqësia t’i largojë ata, mendjet e të cilëve mund të sfidohen nga një arsyesim i qartë dhe i menduar mirë. Sepse kush vepron ndryshe ... tregon se është më i shqetësuar për interesat e veta sesa për ato të Zotit. ... Kjo, pra, është ajo që duhet bërë: duke u nxitur më shumë nga arsyeja dhe butësia, ata duhet të dëshirojnë të na ndjekin, jo të largohen prej nesh, në mënyrë që, duke u treguar atyre atë që ne pohojmë nga Shkrimet e tyre, të mundemi, me ndihmën e Zotit, t’i sjellim në gjirin e Kishës Nënë.”^[1]

Po, si katolikë, ne dëshirojmë që të gjithë—përfshirë edhe popullin hebre—të bëhen katolikë dhe të njohin Jezusin si përmbushjen e Dhjatës së Vjetër. Kjo dëshirë nuk buron nga urrejtja, por nga dashuria, e cila duhet të pasqyrohet në mënyrën se si i trajtojmë ata. A mendojmë vërtet se fyerjet dhe sharjet antisemitike do t’i tërheqin ata drejt Krishtit? Apo, siç sugjeron Shën Gregori, qasje të tilla zbulojnë se motivet reale të dikujt janë egoiste (p.sh., për të tingëlluar “i fortë” dhe për të fituar ndjekës), dhe jo të frymëzuara nga dashuria mbinatyrore dhe shqetësimi për shpëtimin e tyre?

Kur bëhet fjalë për antisemitizmin, ashtu si edhe për sionizmin, shpesh vihet re një dështim për të bërë dallime të duhura. A i kundërshton dikush vendimet dhe veprimet e qeverisë së Izraelit për arsye objektive? Apo sepse ushqen urrejtje ndaj hebrenjve si grup etnik dhe/ose fetar në përgjithësi? Nëse është rasti i parë, atëherë pse duhet të përfshihet fare përkatësia etnike apo fetare? A nuk do të ishte më e saktë të flitej për politikën dhe taktikën e Izraelit, në vend që të përdoret shprehja “hebrenjtë”? Në mënyrë të ngjashme, edhe nëse do të kishte ndonjë të vërtetë në teori të caktuara konspirative që u atribuohen personave me prejardhje hebreje, pse duhet të thuhet se “hebrenjtë” kanë bërë X, Y apo Z, sikur veprimet të tilla t’u atribuoheshin të gjithëve që ndajnë të njëjtën prejardhje? Unë kam prejardhje siciliane, por nuk kam asnjë lidhje me mafian. Të kundërshtosh mafian nuk është “anti-italiane”; por do të ishte e tillë nëse veprimtaria mafioze do t’u atribuohet “italianëve” në përgjithësi, në vend që t’u atribuohet autorëve konkretë.

Nga ana tjetër, njerëzit mund të akuzohen edhe padrejtësisht për antisemitizëm. Dikush mund të mbajë qëndrimin se themelimi i shtetit modern të Izraelit në kohën dhe vendin ku u krijua ishte i papërshtatshëm për arsye të tjera përveç antisemitizmit. Po kështu, individët mund të kritikojnë veprime konkrete të qeverisë izraelite pa qenë antisemitë. Të krishterët mund të diskutojnë historinë biblike dhe implikimet teologjike të mospranimin të vazhdueshëm hebre të Jezusit si Mesia, pa u bërë për këtë arsye fajtorë për antisemitizëm.

Fatkeqësisht, në kohën tonë, ku diskursi publik shpesh drejtohet nga deklaratatë të shkurtra, narrativa të thjeshtuara dhe emocione të forta, etiketimet dhe akuzat priren të errësojnë çështjet reale në fjalë. Konfuzioni shtohet nga fakti se njerëzit mund të mbështesin ose kundërshtojnë veprimet e qeverisë izraelite për një larmi arsyesh të ndryshme. Jo çdo i krishterë që mbështet Izraelin përfaqëson sionizmin e krishterë; dhe jo kushdo që kundërshton veprimet e Izraelit është antisemit.

Diskutimi publik mbi trazirat e rënda që po ndodhin në Tokën e Shenjtë dhe në rajonin përreth është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Megjithatë, një diskutim efektiv mund të pengohet kur debatet mbi etiketimet zëvendësojnë shqyrtimin e kujdesshëm të rrethanave objektive dhe të veprimeve politike vetë.

Fyerjet dhe etiketimet nuk duhet të kenë përparësi ndaj një analize të matur etike dhe politike. Nëse dikush shqetësohet për veprimet e Izraelit në Gaza apo në Iran, ka më shumë gjasa të gjejë mirëkuptim nëse paraqet arsyet faktike pa i përzier ato me sharje etnike apo fetare. Në të kundërt, nëse dikush mbështet veprimet e Izraelit, ka më shumë gjasa të dëgjohej nëse shmang akuzimin e të gjithë kundërshtarëve si domosdoshmërisht antisemitë. Qëndrimet e ndryshme mbi këto çështje komplekse politike duhet të vlerësohen mbi bazën e meritës së argumenteve të paraqitura, dhe jo mbi një mbështetje apo kundërshtim të paracaktuar *a priori* ndaj Izraelit, të bazuar thjesht në racë apo fe.

[1] Gregory I, Qui sincera, letter to bishop Paschasius of Naples (Nov. 602), in Denzinger: Compendium of Creeds, Definitions, and Declarations on Matters of Faith and Morals, 43rd ed., ed. Peter Hünermann (Ignatius, 2012), no. 480.

Date Created

10/04/2026

Author

erasmusi